



10 VJET

Lidhja e Muslimanëve të Aargaut Verband Aargauer Muslime (VAM)

Gara në lexim të Kur'anit për të rinj

Kur lexohet Kur'an, melekët zbresin nga qielli, dëgjojnë dhe i tregojnë Allahut për këtë. A ka gjë më të bukur se recitimi me përkushtim i Kur'anit famëlartë?

I nderuari Imam, e nderuara Kryesi e Xhamisë,

Më 14 Shtator 2014, Verband Aargauer Muslime (VAM) feston jubileun e 10-vjetorit, elhamdulillah. Me ndihmën e Allahut Fuqiptotë dhe me mbështetjen Tuaj, ne jemi përpjekur bashkërisht që institucioneve të shtetit (në nivel federal dhe kantonial), popullsisë, shkollave, kishave dhe mediave (gazetave, radios dhe televizionit) t'jua prezentojmë në mënyrën më të bukur fenë islame dhe muslimanët që jetojnë këtu.

Sot VAM njihet si zë paqësor dhe i besueshëm i muslimanëve në Kantonin Aargau.

Synimi ynë është që muslimanët që jetojnë në Aargau të njihen si forcë pozitive dhe të mund ta praktikojnë të lirë fenë e tyre.

Rinia jonë është ardhmëria jonë. Nga ajo varet se çfarë islami do të jetohet në të ardhmen në kantonin Aargau.

Prandaj, është detyrë e jona që rininë tonë ta entuziazmojmë për islamin si fe dhe ta përgatisim për punë të mëtutjeshme.

Për ta arritur këtë, ne do të tubojmë të rinjtë muslimanë nga nacionalitete të ndryshme së bashku me familjet dhe shoqëritë e tyre në jubileun e 10-vjetorit të VAM.

Me këtë rast, VAM ndër të tjera organizon edhe gara në recitim të Kur'anit. Çdo xhami në kantonin Aargau është e mirëseardhur që ti mbështesë dhe të marrë pjesë në këto gara.

Kjo është ecuria e konkursit:

- Çdo xhami në kantonin Aargau zgjedh nga radhët e veta dy kandidatët më të mirë apo kandidatet më të mira për konkursin e Kur'anit.
- Të drejtë pjesëmarrjeje kanë të gjithë djemtë dhe vajzat e moshës 8 deri 12 vjeç.
- Më 14 Shtator 2014, me rastin e manifestimit të jubileut të VAM, kandidatët dhe kandidatet nga xhamitë e ndryshme do të recitojnë pjesë nga Kur'ani Famëlartë para publikut dhe jurisë.
- Fituesit apo fitueset e tre vendeve të para do të shperblehen me këto çmime :
 - Çmimi i parë: Fr. 300.-
 - Çmimi i dytë: Fr. 200.-
 - Çmimi i tretë: Fr. 100.-
- As të tjerët nuk do të ngelin pa asgjë: scili pjesëmarrës dhe secila pjesëmarrëse do të marrë një medalie si kujtim.

Këto janë rregullat e pjesëmarrjes:

- Çdo nxënës reciton një pjesë nga Kur'ani-kerimi, të cilën e zgjedh vet. Kohëzgjatja maksimale është 3 minuta.
- Juria e pavarur do të vlerësojë sipas këtyre kritereve:
 1. Leximi pa gabime
 2. Respektimi i rregullave të Texhvidit dhe mekami i këndimit
 3. Shkalla e vështirësisë

I nderuari Imam, e nderuara Kryesi e Xhamisë,

Ju lutemi edhe një herë që ta përkrahni këtë projekt fisnik. Ndihamoni të rinjtë dhe nxitni ata që të marrin pjesë në këtë konkurs. A ka gjë më të bukur se të kuptuarit e Kur'anit, leximi i tij dhe të mësuarit e tij të tjerëve?

Afati i paraqitjes: 30 Qershor 2014

Paraqitja: Me e-mail ose postë (formularit përkatës)

Me selame,

Kryesia e VAM

Anmeldetalon für den Qur'anwettbewerb

Bitte schickt diesen Anmeldetalon bis spätestens 30. Juni 2014 zurück an:

VAM, Postfach 1453, 5401 Baden oder via E-Mail: info@aargauermuslime.ch

Name: Alter:

Geschlecht (m/w)

Moschee:

Adresse:

.....

Telefon: E-Mail: